

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**

---

**VENDIM**  
**Nr.75 Datë 11.10.2010**

**PËR**  
**FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË**  
**SHOQËRISË “ENERGY PLUS” SH.P.K NË AKTIVITETIN E**  
**TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 gërma “g”, neneve 8 dhe 10, pikat 1, dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, gërma a, dhe 3, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.10.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Tregëtimit të Energjise Elektrike,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshem dhe rinovimit të licensave si më poshtë:

- o Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni finaciar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- o Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.10) eshte paraqitur dhe plotësuar ne menyre korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për licensë të shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE**



- 
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Bujar NEPRAVISHTA**